



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN  
SEKTORI EMERGJENCEVE CIVILE

Nr. 758 prot.

Peqin, më 30/04/2024

**PROGRAM MASASH**  
"Për parandalimin dhe përballimin e emergjencave në rast zjarri për periudhën  
Qershor-Tetor 2023"

Për mbrojtjen e pyjeve dhe kulloave nga zjarri dhe shpëtimi

1. Do të ngrihet shtabi i mbrojtjes nga zjarri për Bashkinë Peqin.  
**Deri në Prill 2024**
2. Do të bëhet njohja dhe zbatimimi i Ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi" si dhe akteve tjera nënligjore me komunitetin lokal, subjektet juridike dhe fizike që ushtrojnë aktivitetet në fondin pyjor e kullosor, barijtë, OJQ-të, etj.  
**Prill - Maj, 2024**
3. **Deri 10 Prill, 2024**
4. Lidhja e akt-marrëveshjeve midis DSHP-vë të Bashkive në Qarkun Elbasan dhe Policisë Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtim, ADZM-BASHKIA PEQIN, për bashkëpunimin e bashkërendimin e detyrave në shuarjen e zjarrit.  
**Vazhdimisht**
5. Shtabi i MNZSH do të organizojë takime me drejtuesit e pushtetit vendor të Bashkive të Qarkut me qëllim sensibilizimin e opinionit për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri.  
**Deri 10 Maj 2024**
6. Në bashkëpunim me sektorin pyjor Bashkia Peqin në çdo njësi administrative të Bashkisë Peqin do të ngrihen dhe funksionojnë shtabet për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, të cilët në mënyrë të vazhdueshme do të analizojnë gjëndjen e krijuar në teritorin e tyre, gjithashtu do të ngrihen në çdo fshat skuadrat e MNZ (5-7 vetë) të cilët do të instruktohen nga inspektorët e policisë të shërbimit pyjor në zonat respektive.  
**Deri 10 Maj 2024**
7. Në qendrat të Njesive Administrative të Bashkisë Peqin në vënde të dukshme do të vendosen postera edukues për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri.  
**Deri 10 Maj 2024**
8. Shtabi i MNZSH do të organizojë takime dhe biseda me komunitetin lokal dhe nëpërmjet medias elektronike e të shkruar qendrore e lokale, për sensibilizimin e opinionit për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri.  
**Maj-Tetor 2024**

9. Organizimi në një shkallë më të lartë i bashkëpunimit të Bashkisë Peqin me organet e pushtetit qendror, Komisariatin e Policisë Peqin, Shërbimin Vendore të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi.

**Vazhdimisht**

10. Do të organizohen kontrole nga ISHMP-Qarku Elbasan në sektoret pyjore nën administrimin e Bashkisë Peqin tek subjekte private që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor e kullor, për ngritjen, funksionimin e skuadrave të MNZ, pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme për shuarjen e zjarreve si dhe mbajtjen e tyre në gadishmëri.

**Vazhdimisht**

11. Bashkia peqin do të vendosë vrojtues-sinjalizuesit në zona të veçanta me rrezikshmëri më të madhe për rënie zjarri në pyje e kullota.

**Maj-Tetor, 2024**

12. Sektori pyjor i Bashkisë Peqin çdo dy jave do të informojë Prefekturën e Qarkut Elbasan dhe ISHMP-Qendrore Tiranë, për zjarret e rëna, dëmet e shkaktuara dhe masat e marra për eliminimin e tyre.

**Çdo dyjavor**

13. Sektori pyjor i Bashkisë Peqin, në bashkëpunim me DSHP-të në Peqin do të organizojë analiza të veçanta për rastet e rënies së zjarreve në pyje e kullota, duke nxjerrë detyrat që dalin për përmirësimin e punës.

**Per Sektorin e Emergjencave Civile**

**Pergjegjesi Sektorit**

/ Drini Juba /



**KRYETARI I BASHKISE**

/ Bukurosh MAÇI /



## PLANI VJETOR

### I MENAXHIMIT TE ZJARREVE NE PYJE DHE KULLOTA PER VITIN 2024

Në mbështetje e për zbatim të ligjit Nr.9385 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, ligjit Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM Nr. 290, datë 30.04.2004 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota", i ndryshuar Nr. 1080, datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota si dhe për krijimin e njësisve vullnetare për shuarjen e zjarreve" dhe rregullores nr. 1, datë 13.05.2005 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi në pyje e kullota", hartohet ky plan i menaxhimit të zjarreve, për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen:

#### **1.Zonat me rrezik zjarri të lartë dhe periudha më e mundeshme e rënies së tyre :**

Kryesisht objektet me halore si zonat Garunjë e Vogel, Garunjë e Madhe, Galush, Zalli Shkumbin Bardhas, Rrumbullakë, Hasnjok, Paulesh etj.

Periudha më e mundeshme e rënies së zjarreve është Maj-Tetor.

#### **2.Masat dhe aktivitete për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota.**

- Përcaktimi i pikave kryesore të vrojtimit në mënyrë që të mbulohen të gjithë zonat dhe të sigurohet informacion i vazhdueshëm në çdo moment, duke realizuar një shpërndarje të drejtë të vrojtuesve.
- Ngritja instruktimi dhe funksionimi i skuadrave të MNZSH-së në fshatrat që paraqesin rrezikshmëri prej 3-5 vetash për një veprim të shpejtë dhe tepër efektiv, duke aktivizuar personat më aktive.
- ngritja e shtabit të MNZSH-së në bashkëpunim me njësinë administrative.
- ngritja dhe funksionimi i shtabit të MNZSH në Bashkinë Peqin.
- ngritja instruktimi dhe funksionimi i skuadrave të MNZSH-së në zonat me aktivitet me pjesëmarrjen e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në to.
- shërbim i vecantë për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri në pyje ,në sektorin pyjor dhe në Zonat e Mbrojtura dhe pyjet me vlera të vecanta turistike, sidomos ditet e shtuna e të diela duke disiplinuar levizjet e vizitoreve.
- përgatitjen dhe vendosjen e tabelave që sensibilizojnë opinionin publik dhe shkrime me bojra në objekte të palëvizshme, për rrezikun e zjarreve dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, I hedhjes së mbeturinave në pikat e pushimit që bëhen shkak për zjarret.
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organet e pushtetit vendor, policinë e shtetit, PMNZSH.
- hartimin dhe përsosjen e skemave të lajmërimit ,të njohjes me nr. telefoni të personelit të sektorit pyjor, e të strukturave të tjera në bashkëpunim si:PMNZSH-në, njësite administrative dhe Bashkinë Peqin.
- mbajtjen në gadishmëri e sistemit të ndërlidhjes si celularë, telefon fiks.
- vendosjen dhe mbajtjen në gadishmëri të një sasive veglash në afersi të këtyre zonave që paraqesin rrezikshmëri të lartë.

### 3. Identifikimi i mjeteve ,pajisjeve dhe burimeve njerzore.

- Mjetet që do të përdoren në rast zjarri :
  - mjeti kundra zjarrit.
  - mjetet motorrike dhe mjete të tjera që ka bashkia (makinat).
  - mjetet e bizneseve private që ushtrojnë aktivitet brenda këtyre zonave.
- Pajisjet dhe veglat e punës që do të shfrytëzohen janë:
  - uniforma dhe pajisjet speciale të mbrojtjes nga zjarri për skuadren zjarrëfikese dhe përdorimin e mirëmbajtjen e tyre sipas udhëzimit nr. 39 date 30.04.2004.
  - kazma ,lopata, fuci uji, kosore etj. që ka gjendje sektori pyjor dhe ato që janë planifikuar të blihen.
  - veglat dhe mjetet e thjeshta të popullsisë civile dhe të bizneseve që ushtrojnë aktivitet brenda këtyre zonave.
- Burimet njerzore që do te vihen në dispozicion :
  - personeli i shërbimit pyjor.
  - vrojtusit.
  - efektivat e skuadrave te MNZSH.
  - banorë ne afërsi të këtyre zonave.
  - nga bashkepunimi me PMNZSH, pushteti vendor dhe biznesi privat që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor e kullosor.

### 4. Përcaktimi i intenerarit në rast zjarri.

Janë të përcaktuar lëvizjet e mjeteve në rast zjarri në këto zona pasi është i njohur plotësisht rrjeti rrugor që përshkon ato duke përcaktuar variantet që sigurojnë shpejtesinë e duhur dhe shpenzime më të pakta, po kështu dhe rrugët këmbësore për lehtëzjen e skuadrave të MNZSH dhe njihet mirë konfiguracioni i terrenit.

### 5. Masat teknike për parandalimin e zjarreve.

- Këto masa i referohen operacioneve silvikulturore dhe të mirëmbajtjes si:
  - hapjen e koridoreve mbrojtjes.
  - mirëmbajtjen e koridoreve ekzistuese, pastrimin, heqjen e mbeturinave dhe drurëve të rrëzuar.
  - krasitje ne 1/3 e kurores në pyjet halore.

### 6. Aktivitet e trajnimit dhe informimit publik.

- Në këto masa me karakter sensibilizues që do të ndermerren po përmendim:
    - spote publicitare.
    - takime me nxënësit e shkollave dhe popullsinë locale për rëndësinë e pyjeve.
    - organizimi seminareve në shkëmbimit të eksperiencave dhe përcaktimit të masave për tu ndërmarrë ne të ardhmen.
- Në drejtim të zbatimit të këtij plani Sektori Pyjor pranë bashkise Peqin do të ushtroj kontrole në Njësitë Administrative dhe për cdo rast zjarri do të bëhen analiza të vecanta dhe do të merren masat e nevojshme për përmirsimin e punës.

**7. NEVOJAT FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SEZONIT TË ZJARREVE  
(PER VITIN 2024)**

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia e matjes	SHUMA TOTALE	
			Sasia	Vlera 000/leke
1	2	3	4	5
1	Shkruajtje parrullash	copë	55	4
2	Blerje mjetesh te thjeshta	Kazma	"	
		Lopata	"	
		Sopata,kosore	"	
		Krëhra	"	
		Fikse zjarri	"	
		Fuçi uji	"	
		Bishta vëglash	"	
		Të tjera	"	
3	Masat silvikulturore	Hapje brezash	Ha	
		Pastrime	"	43
		Të tjera		
4	Nevoja për vrojtues	Nr.	5	1824
5	Spote publicitare	000/leke		20
6	Paga për shuarje zjarri			550
7	Karburant (nafte+ben)	Litra	1500	260
8	Shërbime e dieta	000/leke		10
9	Të tjera			50
<b>SHUMA</b>				<b>3591</b>

PER EMERGJENCAT CIVILE  
Shefi Emergj.Civile  
/ Drini Juba /



KRYETARI BASHKISE  
/ Bukurosh MACI /



3. Për rastin e zjarrit të nëndheshëm bëhen kanale e izolimi 0,7-1m. thellësi dhe 1-1,5m gjerësi. Faqet e kanalit sperkaten me ujë.

### ORGANIZIMI I PUNIMEVE PËR SHUARJEN E ZJARRIT

Menjëherë pas rënies së zjarrit dhe izolimit të tij jepet kushtrimi; fillimisht lajmerohet kryetari i fshatit më të afërt, reparti MKZ, skuadrat zjarrfikëse të fshatrave, qendra sektorit, drejtoria e shërbimit pyjor, Këshilli i rrethit. Mbase merren të dhënat e para për ekonomine, ngastrën dhe shkahun e shfaqjes së zjarrit. menjëherë njoftohet Ministria Mjedisit, Pyjeve dhe Kullotave në Tiranë, jo me vonë se 8-12 ore nga shfaqja e zjarrit. Njoftimi i Ministrisë jepet i plotë si: ora, data, shkaku i rënies, gjetja ose jo e shkaktarëve, ekonomia pyjore, numuri i parcelës, karakteristikat dendrometrike të grumbullit, masat që janë marrë për shuarjen e tij si dhe dëmi fillestar. Mbas shuarjes së zjarrit bëhet njoftimi përfundimtar me shkrim, data, ora e shuarjes së zjarrit, sipërfaqja e përshkuar, sipërfaqja e djegur, lloji drusor, vlera e dëmit, mundësia e përdorimit të materialit drusor, masat e marra ndaj shkaktarëve. Në rast se zjarri vazhdon për 2 e më shumë dite, njoftohen organet eprore çdo dite.

Udhehoqës për shuarjen e zjarrit në pyll janë përfaqesuesit e sektorit të MNZ dhe në mungesë të tyre, organet e rendit dhe personeli i shërbimit pyjor.

Shtabi i MNZSH për drejtorinë e shërbimit pyjor përcakton mjetet, forcat, përcakton menyren e shuarjes së zjarrit, furnizimin me forca e vegla pune dhe organizimin konkret të punes. Organet e MNZSH, personeli pyjor kur arrijnë në vendin e zjarrit përcakton sipërfaqen e djegur, drejtimin dhe shpejtesinë e përhapjes së zjarrit dhe merr masa për kufizimin e tij. Në vendin e zjarrit krijohet shtabi i organi-zimit të punes me detyra të ndara për secilin anëtar dhe pjesën ku do të organizojë forcat për fikjen e tij.

Mbas shuarjes së zjarrit në sipërfaqen e djegur liben punetore dhe personel pyjor që kontrollon të gjitha punimet që kryhen për shuarjen e plotë të tij dhe mbahet lidhje me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor e cila organizon edhe furnizimin e punëtoreve që janë në vendin e zjarrit, me ushqime, ujë, batanije, vegla të ndryshme, etj.

## ORGANIZIMI I SISTEMIT TE VROJTIMIT DHE SINJALIZIMIT

Me gjithë masat e marra për parandalimin e zjarreve, ai përsëri mund të shfaqet, prandaj me qëllim që ato të kufizohen e të shuhen sa janë në fazën fillestare duhet të organizohet sistemi i vrojtimit dhe sinjalizimit.

Njoftimi i saktë, i dhënë në kohe, lehtëson vleresimin e shpejtë të situates dhe ndihmon në organizimin dhe marrjen e masave të menjëhershme e sa më efektive.

Sistemi i vrojtimit organizohet në patrulla dhe vrojtues në pika të larta e dominuese.

Patrulluesi duhet të njohë mirë vendin, topografinë e terrenit, vendet e ndërlidhjes dhe skuadrat vullnetare MNZ që veprojnë në teritorin ku patrullon.

Per patrullim mund të ngarkohen veç inspektoreve të policisë të shërbimit pyjor edhe persona që kanë mbaruar teknikumin pyjor. Patrullat caktohen në periudhën më të vështirë të shfaqjes së zjarrit.

Pikat e vrojtimit kryesorë vrojtojnë pjesën më të madhe të territorit, pikat e dyta caktohen për të parë ato sipërfaqe që nuk vrojtohen nga pikat kryesore dhe pika ndihmëse për të vrojtuar sipërfaqe ku rreziku i rënies së zjarrit është më i madh, ose për të ruajtur në ditët me pamje të kufizuara.

Patrulluesit duhet të pajisen me mjete ndërlidhjeje, harta dhe fletore shënimesh. Për ndërlidhje të përdoret mjete telefonik, etj., ndërsa atje ku nuk ka mundësi të përdoret komunikimi me sinjal dhe korrier. Kur vrojtohet zjarr, vrojtuesi njofton mejeherë rojen e shërbimit, vendin e saktë të rënies së zjarrit, madhësinë e tij dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme. Roja i shërbimit regjistron informacionin dhe menjëherë njofton drejtuesit e Drejtorisë të Shërbimit pyjor, Komandantit të policisë, Keshillin e rrethit, Ministrinë e Mjedisit dhe Pyjeve në Tiranë.

Vrojtimi dhe informacioni deri në shuarjen e zjarrit duhet të jete i pandëprerë. Për këtë qëllim janë marrë masa parandaluese, vrojtim-sinjalizimi, si dhe pajisja me mjete ndërlidhjeje.

## GJATE SHUARJES SE ZJARRIT NE PYLLE

Shtabi i shuarjes së zjarrit, krahas masave organizative për mobilizimin e forcave për shuarjen dhe izolimin e zjarreve, duhet të marrë masa për menjanimin e aksidenteve që mund të ndodhin gjatë punës. Këto masa përmblihen:

1. Inspektori i policisë pyjore i zonës të njohë mirë territorin për shpërndarjen dhe tërheqjen e forcave në rast zjarri.
2. Organizon patrulla gjatë gjithë perimetrit të zjarrit, në çdo 15-20m., i cili ndjek ecurinë e zjarrit.
3. Ndalohet rreshtimi i forcave në vende të pjerreta, shkembore dhe gremina, të cilat mund të bëhen shkak për rrezimin e tyre.
4. Kur ka shume tym, tërhiqen forcat derisa të pastrohet mjedisi.
5. Rreshtimi i forcave bëhet në mënyre që të mos pengojnë njëri-tjetrin, sidomos gjatë shuarjes së zjarrit sipërfaqësor.
6. Gjatë natës patrullat duhet të jenë më të dendura.
7. Kur ka erë të forte dhe që ndryshon drejtimi, bëhet tërheqja e punëtorëve në distance 30-50m.
8. Kur koha e shuarjes së zjarrit zgjatet, punëtorët të punojnë me nderese.
9. Nuk lejohet që forcat që punojnë për shuarjen e zjarrit të jenë të zhveshur pa mjete mbrojtëse dhe pa veglat e domosdoshme të punës.
10. Shtabi i mbrojtjes nga zjarri duhet të ketë një minimum barnash mjeksorë kundër djegies apo dëmtime të ndryshme.
11. Gjatë krijimit të zonave apo brezave të izolimit të zbatohen rregullat e shfrytëzimit të pyjeve.



# PËR SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE

*Instruksion metodik*

Mënyrat për shuarjen e zjarreve ne pyje

Mënyra direkte konsiston në izolimin e materialit të djegshëm nga ajri ose burimi i xehhtësisë, i cili realizohet në këto mënyra:

1. Për rastin e zjarrit sipërfaqësor: zjarri mund të mbulohet me dhe ose rërë. Mbulimi bëhet me vegla dore si lopata, kazma, shata, bela, etj. Në vende të veçanta dhe në fillim të çfaqjes së tij, zjarri mund të shuhet dhe lokalizohet me rrahjen e tij me fshesë të bërë me degë të llojeve fletore. Rrahja bëhet duke qëndruar ballë-përballë me zjarrin ose në krah të tij. Rëndësi ka pastrimi i legu-shes dhe i mbeturinave të thata duke i hedhur mbi zjarr; ky veprim duhet të bëhet me kujdes për të mënjeluar përhapjen e tij. Shuarja e zjarreve me ujë, bëhet vetëm në rastin e zjarreve sipërfaqësor ku për 1 m<sup>2</sup> duhen 1-2,5 litra ujë, i cili hidhet me kova, pompa dore ose motorrike.

Për shuarjen e zjarrit përdoren edhe lëndët kimike, të cilat gjatë shkrirjes formojnë një shtresë izolimi rreth lëndëve organike duke ndaluar lidhjet me oksigjenin, e për rrjedhojë zjarri shuhet. Përdoren lëndë kimike të ngurta ose të gazta zakonisht disosfat amoniumi dhe më rrallë acid fosforik, klorur magnezi sulfat amoniumi, etj. Për hedhjen e lëndëve kimike përdoren aeroplane të posaçëm, helikopter, etj.

Me këto mjete mund të hidhen veç bombave e predhave më lëndë kimike edhe bomba e predha plasëse kundër zjarrit.

Izolimi i zjarrit të rënë nga pjesa tjetër e pyllit bëhet me breza, zona dhe kanale, kufizohet si në pjesën ballore të zjarrit dhe në ane të tij; brezat e izolimit bëhen me gjerësi 0,5-2-4 m. Gjerësia është në funksion të shpejtësisë dhe intensitetit të zjarrit faktoreve meteorologjike, materialit të djegshëm, legusha dhe mbeturinat e tjera të thata në brez pastrohen derisa të dalë toka. Legusha dhe mbeturinat e dala nga pastrimi hidhen në anën e zjarrit ose në brendësi të tij për t'u djegur. Toka e brezit punohet me kazem, bel, lopate, a vegla të tjera pune. Brezi i izolimit bëhet edhe duke sperkatur tokën e brezit me lende kimike kundër zjarrit.

2. Në rastin e zjarrit të kurorave: për kufizimin e zjarrit hapen zona izolimi. Ndertimi i tyre bëhet duke prerë me shpejtësi një rryp pylli me gjerësi aq sa një lartësi Trugishte. Cungishte e rregullt dhe rreth 5-8m. për shkurret e makiet. Druret në këtë rryp toke priten me sopate, sharre, motosharre ose thërmohen me dinamit. Në makie ose shkurre, pylli i prerë hidhet nga ana e zjarrit, sepse nga dendësia e madhe e tyre, pastrimi, nxjerrja jashtë është shumë e vështirë.

Fikja e zjarrit me zjarr është një mënyrë tjetër për izolimin e zjarrit të rënë në pyje. Kjo praktikohet si për zjarrin sipërfaqësor, ashtu dhe për atë të kurorës. Kjo përdoret kur mënyrat tjera nuk japin rezultat. Mënyra e fikjes së zjarreve me zjarr bëhet duke djegur pyll në një brez të ngushtë gjatë gjithë perimetrit të zjarrit. Ndezja bëhet me shumë kujdes për të mos u bërë shkak për përhapjen e tij. Në këto raste vihen edhe punëtoreshë shtetërore. Distanca e hapjes së zonave të izolimit dhe të rrypit të zjarrit kundër zjarrit, nga pika më e afërt e zjarrit ekzistues, varet nga shpejtësia e përhapjes së zjarrit nga mjetet dhe fuqia punëtoreshë. Kjo është kompetencë e shtabit të ngritur për izolimin dhe shuarjen e zjarreve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

Nr. 759/ Prot.

Peqin, më 30/04/2024

Lenda: Shkresë percjellese

Drejtuar: PREFEKTIT TE QARKUT ELBASAN

Ne pergjigje te shkreses tuaj nr.488.prot, date 16.4.2024 "Mbi marrjen e masave, per perballimin e emergjencave verore dhe informim" bashkelidhur po ju dergojme programin e masave te Bashkise Peqin per parandalimin dhe perballimin e emergjencave civile verore 2024.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

KRYETARI I BASHKISE

/ Bukurosh MAÇI /